

VENDIM
Nr.109, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z. SHABAN MERKAJ, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR LAPARDHA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Shaban Merkaj, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllo,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z. Shaban Merkaj, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllo për “TV Lapardha”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Otlak.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati